



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY SH.A

Data __. __. 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “*Kancelari*”.

LLOJI I PROCEDURES: Procedurë e hapur e thjeshtuar

VLERA E FONDIT LIMIT : **1,317,100** (një milion e treqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind lekë), **lekë pa TVSH.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

(22852000-7; 30192124-6; 22816100-4; 30199230-1; 30237460-1; etj)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Seaports Development Company sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Për realizimin e objektit të prokurimit, Autoriteti Kontraktor kërkon nga Operatorët ekonomik kur te paraqiten prane Autoritetit Kontraktor Albanian Seaports Development sh. a, të dorëzojë dokumentat si më poshtë:

1. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2020-2021-2022), ku vlera e

xhiros minimale vjetore, për të pakten një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Për kapacitetin teknik:

2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % nga vlera e përlllogaritur e fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të

përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuara) te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:

- **Certifikim i Operatorit Ekonomik per ISO 9001: 2015 ose ekuivalent** i cili duhet te perkoje me kategorie dhe specifiken e produkteve dhe te sherbimeve qe prokurohen.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

*Përmbushja e standartit **ISO 9001:2015 ose ekuivalent** është i rëndësishem për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.*

Kjo certifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundeson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe infrastrukturës.

2.3 Produktet e ofruara duhet të jenë të reja si dhe të kenë garanci përdorimi jo me pak se **12 muaj** nga marrja e tyre në dorëzim. Tek te gjithë artikujt ku jane percaktuar permasat fikse, do te pranohet tolerance (+ ose - 2%).

Për cdo rast kur malli nuk përmbush kriteret e kërkuara sipas specifikimeve teknike (apo ka demtime), produkti nuk do të pranohet nga Komisioni i Marrjes në Dorëzim.

2.4 Operatori ekonomik ofertues duhet paraqesë një deklaratë me shkrim që merr përsipër me mjetet e veta dhe me punonjësit e vet të realizojë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në kohë dhe në sasi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor;

2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra per artikujt te cilet kane përdorueshmëri më të lartë për institucionin, perkatesisht per zerat ne preventiv me numer rendor 2, 3, 17, 18, 29, 41, 44, 47, 55, 69, 70, 77, 94 me qëllim verifikimin nëse këto produkte plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes se procedures. Mostrat duhet të jenë të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur dhe së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht për skualifikim.

Mostrat do te dorezohen perpara K.V.O-së, ne oren dhe daten e percaktuar per hapjen e ofertave, prane zyrave te ASDC.

Shënim: Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e paraqitura nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja e mostrave përbën kusht për skualifikim. Mostrat do ti kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne piken 6 /a te nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Paraqitja e mostrave per artikullin qe eshte objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise ne vend te mallit qe operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike te percaktuara ne DST, dhe duke qene se malli ka nje natyre te vecante.

Afati i lëvrimit të mallrave është 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontrates.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, duhet te përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe duhet të jenë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Komisioni i Prokurimeve me Vlere te Vogel ia bashkangjit procedures se

prokurimit me vlere te vogel sa me sipercituar dhe mbi bazën e tyre procedon edhe me hartimin e kritereve për kualifikim.

Specifikimet teknike janë vendosur në bazë nenit 36 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 40, pika 6 /a të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në të cilën citohet se: "Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit”.

Komisioni:

Ervisa Rama	Kryetar	_____
Elvis Dafku	Anëtar	_____
Enxhi Koka	Anëtar	_____